



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

|   |   |  |
|---|---|--|
| <b>Blerina Huruglica-Eksperte</b><br><b>Shqyrtues</b><br><b>Lindita Avdyli-Eksperte Teknike</b> | <b>Data e autorizimit të</b><br><b>ekspertit</b><br><b>12.11.2020</b> | <b>Data e dorëzimit të raportit</b><br><b>23.11.2020</b> |
|---|---|--|

**1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: **05.11.2020**, OE “**LiriMed**”, ka parashtruar ankesë me nr: **899/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “**Agani LTD**” lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Furnizim me barna nga Lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së**” me nr. të prokurimit: **00220-20-5506-1-1-1**, (për Lot 3), iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SHSKUK**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **422 567,76€**.

**Lot 1: 5,616.00€**

**Lot 2: 13,225.00€**

**Lot 3: 394,793.00€**

**Lot 4: 8,933.76.00€**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Data e njoftimit për kontratë: **18.09.2020**,

Data e hapjes së ofertës: **15.10.2020**,

Data e njoftimit për dhënien e kontratës: **21.10.2020**,

Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm: **21.10.2020**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**2.PRETENDIMET ANKIMORE**

### Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit:

Të nderuar ne me dt. 21.10.2020 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë për Lot 3 "Agani L.T.D" SH.P.K, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar.

AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar për Lot 3 që na ka dërguar neve e ka shënuar se jeni eliminuar për këto arsye: *"Për Lot 3: (Heparin natrium-Injeksion: 5000 IU/mL; në ampula 1 mL), nuk keni ofertuar me produktin e kërkuar, por keni ofertuar: (heparin natrium-Injeksion: 5000 IU mL; në ampula 5mL); Oferta juaj e tejkalon substancialisht buxhetin e autoritetit kontraktues në dispozicion për Lot 3 "*

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi pasur kontrata paraprake të lidhura me AK për këtë produkt, ndërsa kontrata e fundit është shkëputur ne mënyrë miqësore për shkak të rritjes së çmimit të heparisë në nivel global për më shumë se 120%, faktin se është bërë rritja çmimit e vërteton edhe dëshmia nga prodhuesi dhe referencat të cilat po ju bashkangjesim në kërkesën për rishqyrtim.

**(Bashkangjitur keni dëshminë nga prodhuesi dhe referencat).**

Ndërsa AK-ja pas shkëputjes së kontratës ne mënyrë miqësore, e ka hapur prapë tenderin por me çmim të njëjtë të planifikuar prej 3.50 euro për ampule.

Sa i përket arsyes së parë për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ju sqarojmë se ne kemi ofertuar në **Lot 3** me heparin 5000IU/ml, 5ml ndërsa ne listën esenciale është 5000IU/ml, lml , d.m.th. doza jonë e ofertuar është **në përputhje me listën esenciale**, por vetëm vëllimi është 5 herë më i madh se ai që është kërkuar pra lml , ndërsa ne e kemi ofruar 5ml, pra produkti me të cilin nekemi ofertuar është i regjistruar në Kosovë, pavarësisht që ne kemi ofertuar me dozën më të madhe 5ml. Mirëpo në këtë rast me rëndësi është se produkti i kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit për Lot 3 është i regjistruar në Kosovë në bazë të UA 01/2015, pra ekziston paralele e regjistruar në Kosovë.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e kemi të regjistruar produktin Heparin me dozë 5 ml, por në këtë rast nuk luan ndonjë rol dhe ndonjë rëndësi doza por me rëndësi është se ky produkt është i regjistruar në Kosovë. Doza nuk është kryesore por kryesore është vetë produkti, kurse produkti është i regjistruar në Kosovë. Sa i përket ofertës tonë që ne kemi ofertuar me dozë 5 ml, ndërsa është kërkuar që të ofertohej me 1 ml, ju sqarojmë se ky fakt nuk ka asnjë rëndësi dhe nuk ka ndonjë efekt negativ, pasi që në këtë rast është doza më e madhe dhe mund të përdoret vetëm lml kurse pjesa tjetër mos të përdoret, ndërsa do të ishte e kundërta dhe do të ndikonte në proces nëse do të ishte kërkuar doza më e madhe dhe do të ishte ofruar nga ne doza më e vogël.

Fakti i ofertimit me 5 ml, e jo siç është kërkuar 1 ml paraqet devijim të vogël sipas nenit 59.4 pika (ii) pasi që ky fakt përbën vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sa i përket arsyes së dytë për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ku AK-ja e ka cekur se oferta jonë e tejkalon buxhetin e AK-së që ka në dispozicion, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së nuk qëndron për faktin se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE oferta e të



cilit është me çmim prej 228,979.94 euro për produkt, pra 5 herë më të vogël. Nëse ky produkt krahasohet me produktin tonë me të cilin kemi ofertuar e që është 5 herë më i madh d.m.th.  $228,979.94 \times 5 = 1,144,899.70$  euro, ky produkt do t'i kushton AK-së 150,000.00 euro me shtrenjtë sesa produkti i ofruar nga ana jonë me dozë 5 herë më të madhe se OE i rekomanduar për kontratë. Andaj është për tu habitur se si AK-ja ka ardh në përfundim se oferta e jonë e kalon buxhetin që e ka në dispozicion, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nga llogaria e bërë më lartë i bie që produkti i ofruar nga ai do të i kushtoj AK-së 150,000.00euro më shtrenjtë se sa oferta jonë dhe nuk e tejkalon buxhetin që ka AK-ja në dispozicion. Andaj shihet qartë se ky arsyetim i AK-së për eliminimin tonë është kundërtthënës sepse po përdoren standarde të dyfishta ku për ofertën tonë e ka cekur se e tejkalon buxhetin që e ka në dispozicion, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk e tejkalon edhe pse ne e sqaruam më lartë shumë qartë se produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë do të ju kushtojë AK-së 150,000.00 euro më shtrenjtë se oferta jonë, pra ne kemi ofertuar me çmim total prej 992,622.40 euro çmim ky i rritur dhe i arsyetuar nga prodhuesi.

Gjithashtu AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën e parashikuar tek neni 9.1&9.2 i FDT-së në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional ku shkruan **"Kërkesa 2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlen UA 02 2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruar në Republikën e Kosovës"**.

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar autorizim marketing për produktin në fjalë sipas udhëzimit administrativ 01/2015, ndërsa nuk janë përmbushur kushtet ligjore për përdorim dhe shfrytëzim të udhëzimit administrativ 02/2014, për shkak se ekziston paralele e produktit e regjistruar në Kosovë (ne e kemi të regjistruar këtë produkt).

Udhëzimi Administrativ 02/2014 për thjeshtësimin e procedurave për importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës e parasheh qartë procedurat dhe mënyrën e importimit të produkteve të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Kosovë.

Neni 2 paragrafi 2 i UA 02/2014 e parasheh qartë ku shkruan *"subjekt i këtij udhëzimi administrativ do të jenë vetëm seritë e produkte medicinale që qarkullojnë në tregun e BE dhe të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës"*

Pra kjo dispozitë përcakton qartë dhe flet vetëm për produktet medicinale dhe nuk flet dhe nuk përcakton as dozë e as vëllim të produkteve por i përmend vetëm produktet.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ kuptohet qartë dhe rezulton se ne e kemi të regjistruar produktin dhe është fakt i qartë se ekziston paralele e produktit në Kosovë, prandaj nuk mund të ofertohet nga askush dhe nuk lejohet të ofertohet duke u bazuar në UA 02/2014 në këtë rast, sepse nuk ka hapësirë ligjore përdorimi i të njëjtit udhëzim administrativ.

Në këtë aktivitet të prokurimit OE Agani është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar me produktin e pa regjistruar, duke u munduar të mbështetet tek UA 02/2014, i cili udhëzim lejon importin e produkteve të pa regjistruara në Kosovë, kur nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, andaj OE i



rekomanduar për kontratë nuk mund të importoj këtë produkt sipas UA 02/2014, pasi që ne e kemi te regjistruar në Kosovë këtë produkt, pra ekziston paralele, pavarësisht se AK-ja e ka kërkuar dozën më të vogël 1 ml ndërsa ne e kemi ofruar dozën 5 ml. Karakteristika dhe elementi i dozës apo vëllimit nuk është i përcaktuar në udhëzimin administrativ 02/2014 por është i përcaktuar vetëm produkti.

Faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importoj këtë produkt në Kosovë duke u mbështetur tek UA 02/14 e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij me nr.628/20, sikurse është rast edhe tani, e ku e ka vërtetuar pretendimin tonë për Lot 2 dhe e ka cekur se në bazë të nenit 2.5 të UA 02/2014 citojmë “Baza për vendimmarrje në përputhje me këtë udhëzim administrativ do të jetë lista e produkteve të regjistruara në AKPPM në bazë të nivelit të 5 të kodit ATC dhe formës farmaceutike”, pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importojë produktin e kërkuar andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Ne ju referuam ekspertizës në lidhje me ankesën tonë të mëhershme ku rast ka qenë i njëjtë, prandaj OE Agani në këtë rast është i papërgjegjshëm dhe duhet eliminuar nga konkurrenca.

Andaj OE i rekomanduar për kontratë për Lot 3 është i papërgjegjshëm pasi që nuk mund të importoj këtë produkt ku ekziston paralele e këtij produkti në Kosovë.

Sa i perket LOT 2, çmimi i planifikuar është gabim , kërkojme që të aprovohet çmimi i ofertuar

Ne me dt.02.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne e kemi cekur shumë qartë se në këtë rast kështu siç kemi ofertuar ne nuk luan ndonjë rol dhe ndonjë rëndësi doza por me rëndësi është se ky produkt është i regjistruar në Kosovë. Doza nuk është kryesore por kryesore është vetë produkti, kurse produkti është i regjistruar në Kosovë.

Sa i përket ofertës tonë që ne kemi ofertuar me dozë 5 ml, ndërsa është kërkuar që të ofertohej me 1 ml, ky fakt nuk ka asnjë rëndësi dhe nuk ka ndonjë efekt negativ, pasi që në këtë rast është doza më e madhe dhe mund të përdoret vetëm 1ml kurse pjesa tjetër mos të përdoret, ndërsa do të ishte e kundërta dhe do të ndikonte në proces nëse do të ishte kërkuar doza më e madhe dhe do të ishte ofruar nga ne doza më e vogël.

Mirëpo edhe pse shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë AK-ja përsëri na ka diskriminuar neve duke e rekomanduar për kontratë një OE i cili ka ofertuar me produktin e pa regjistruar, duke u munduar të mbështetet tek UA 02/2014, udhëzim ky i cili lejon importin e produkteve të pa regjistruara në Kosovë, kur nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, andaj OE i rekomanduar për kontratë nuk mund të importoj këtë produkt sipas UA 02/2014, pasi që ne e kemi te regjistruar në Kosovë këtë produkt, pra ekziston paralele. Ndërsa faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importoj këtë produkt në Kosovë duke u mbështetur tek UA 02/14 e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues në vendimin e tij me nr.628/20, në një rast identik siç është ky tani, e ku e ka vërtetuar pretendimin tonë për Lot 2 dhe e ka cekur se në bazë të nenit 2.5 të UA 02/2014 citojmë “Baza për vendimmarrje në përputhje me këtë udhëzim administrativ do të jetë lista e produkteve të regjistruara në AKPPM në bazë të nivelit të 5 të kodit



ATC dhe formës farmaceutike. Gjithashtu paneli shqyrtues e ka cekur shumë qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret sipas UA 02/2014", pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importojë produktin e kërkuar andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Ne ju referuam vendimit të OSHP-së në lidhje me ankesën tonë të mëhershme ku rasti ka qenë i njëjtë, prandaj OE Agani në këtë rast është i papërgjegjshëm dhe duhet eliminuar nga konkurrenca.

Ndërsa sa i përket arsyes tjetër të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur kërkesën tonë të mëhershme për shkëputjen e kontratës në lidhje me këtë produkt, ju sqarojmë se shkëputja e kontratës është bërë në mënyrë miqësore si nga ana jonë ashtu edhe nga AK-së, mirëpo ne e kemi sqaruar shumë qartë se përse e kemi bërë shkëputjen e kontratës, pra shkaku kryesor ka qenë rritja e çmimit të heparinës në nivel global për më shumë se 120%, ndërsa faktin se është bërë rritja çmimit e vërteton edhe dëshmia nga prodhuesi dhe referencat të cilat po ju bashkangjesim edhe në ankesë. **(Bashkangjitur keni dëshminë nga prodhuesi dhe referencat)**, pra kjo është arsyeja e vetme se përse nuk është importuar ky produkt.

Po ashtu në lidhje me arsyen e AK-së ku e ka cekur se ne kemi bërë tejkalimin substancial të buxhetit të AK-së, ne e kemi cekur shumë qartë se nëse produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë krahasohet me produktin tonë me të cilin kemi ofertuar e që është 5 herë më i madh d.m.th.  $228,979.94 \times 5 = 1,144,899.70$  euro, ky produkt do t'i kushton AK-së 150,000.00 euro me shtrenjtë sesa produkti i ofruar nga ana jonë me dozë 5 herë më të madhe se OE i rekomanduar për kontratë, andaj këtu shihet qartë se AK-ja po përdor standarde të dyfishta ku për ofertën tonë e ka cekur se e tejkalon buxhetin që e ka në dispozicion, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk e tejkalon.

Gjithashtu AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim vetëm se i ka vërtetuar pretendimet tona ankimore, kundrejt OE të rekomanduar për kontratë pasi që nuk ka dhënë ndonjë fakt/dëshmi se pretendimet tona nuk qëndrojnë.

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe gjithashtu po shihet qartë favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë pasi që nuk janë shqyrtuar fare pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi E1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve

përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### **VENDIM**

**APROVOHET** ankesa e OE "Liri-Med" si e bazuar,

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për Lot 3 dhe njoftimi për anulim të lot 2 dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**,

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

#### **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 64 i LPP-së  
Neni 66 i LPP-së  
Neni 67 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së.

### **3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET**

**Njoftimi për kontratë:**



**Kërkesa 1.** Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesit. Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri, kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.

**Evidenca 1.** Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi të verifikimit). Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.

**Kërkesa 2.** Autorizimi për Marketing në Kosovë, nga AKPPM sipas UA 01 2015, me dozën e produkteve të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlenë UA 02 2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruar në Republikën e Kosovës.

**Evidenca 2.** Të dëshmohet regjistrimi i barit - Autorizimi për marketing nga AKPPM, me dozën e produktit të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlenë UA 02 2014 dhe për dëshmi -Kopja e Certifikatës së Autorizim Marketingut në një vend të BE (si dëshmi se produkti qarkullon në BE).

#### 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale vetëm oferta e OE Agani është e përgjegjshme, ndërsa oferta e OE LIRI MED nuk është e përgjegjshme.

Në Njoftim për Kontrate si dhe në Dosje të Tenderit është kërkuar:

**Kërkesa 2.** Autorizimi për Marketing në Kosovë, nga AKPPM sipas UA 012015, me dozën e produkteve të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlenë UA 02 2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruar në Republikën e Kosovës.

**Evidenca 2.** Të dëshmohet regjistrimi i barit - Autorizimi për marketing nga AKPPM, me dozën e produktit të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlenë UA 02 2014 dhe për dëshmi -Kopja e Certifikatës së Autorizim Marketingut në një vend të BE (si dëshmi se produkti qarkullon në BE).

- Autorizimi i Marketingut i prezantuar në oferte për Lot 1 është i skaduar.

për Lot 3: (heparin natrium- Injeksion: 5000IU/ mL; në ampulla 1 mL), nuk ka ofertuar me produktin e kërkuar, por ka ofertuar: (heparin natrium-Injeksion: 5000IU/ mL; në ampulla 5 mL)

Oferta e tejkalon substancialisht buxhetin e Autoritetit Kontraktues në dispozicion për Lot: 1,2 dhe 3.

#### 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

#### 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

#### 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Ekspertja Shqyrtuese** fillimisht sqaron se, sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit, meqenëse Ekspertja Shqyrtuese nuk e posedon profesionin e caktuar, atëhere OSHP ka angazhuar një Eksperte Teknike/Profesionale që të bëjë vlerësimin e pretendimeve të caktuara.

**OE ankuesi është eliminuar me arsyetimimin:**

AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar për Lot 3 që na ka dërguar neve e ka shënuar se jeni eliminuar për këto arsye: *"Për Lot 3: (Heparin natrium-Injeksion: 5000 IU/mL; në ampula 1 mL), nuk keni ofertuar me produktin e kërkuar, por keni ofertuar: (heparin natrium-Injeksion: 5000 IU mL; në ampula 5mL); Oferta juaj e tejkalon substancialisht buxhetin e autoritetit kontraktues në dispozicion për Lot 3 "*.

**Pretendimi i parë i OE ankuesit mëposhtë:**

Sa i përket arsyes së parë për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ju sqarojmë se ne kemi ofertuar në **Lot 3** me heparin 5000IU/ml, 5ml ndërsa ne listën esenciale është 5000IU/ml, 1ml , d.m.th. doza jonë e ofertuar është **në përputhje me listën esenciale**, por vetëm vëllimi është 5 herë me i madh se ai që është kërkuar pra 1ml , ndërsa ne e kemi ofruar 5ml, pra produkti me të cilin ne kemi ofertuar është i regjistruar në Kosovë, pavarësisht që ne kemi ofertuar me dozën më të madhe 5ml. Mirëpo në këtë rast me rëndësi është se produkti i kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit për Lot 3 është i regjistruar në Kosovë në bazë të UA 01/2015, pra ekziston paralele e regjistruar në Kosovë.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e kemi të regjistruar produktin Heparin me dozë 5 ml, por në këtë rast nuk luan ndonjë rol dhe ndonjë rëndësi doza por me rëndësi është se ky produkt është i regjistruar në Kosovë. Doza nuk është kryesore por kryesore është vetë produkti, kurse produkti është i regjistruar në Kosovë. Sa i përket ofertës tonë që ne kemi ofertuar me dozë 5 ml, ndërsa është kërkuar që të ofertohej me 1 ml, ju sqarojmë se ky fakt nuk ka asnjë rëndësi dhe nuk ka ndonjë efekt negativ, pasi që në këtë rast është doza më e madhe dhe mund të përdoret vetëm 1ml kurse pjesa tjetër mos të përdoret, ndërsa do të ishte e kundërta dhe do të ndikonte në proces nëse do të ishte kërkuar doza më e madhe dhe do të ishte ofruar nga ne doza më e vogël.

Fakti i ofertimit me 5 ml, e jo siç është kërkuar 1 ml paraqet devijim të vogël sipas nenit 59.4 pika (ii) pasi që ky fakt përbën vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

**Ekspertja Teknike/Profesionale ka sqaruar se,**

Produktet Heparin 500IU/ml, 1ml dhe Heparin 5000IU/ml, 5ml kanë përqendrim të njëjtë të substancës aktive dhe se dallimi ekziston vetëm në vëllim, pra kemi të bëjmë me paketim 1ml dhe 5 ml.

**Ekspertja Shqyrtuese** konform Ekspertës Profesionale pretendimin e OE ankuesit e gjenë **të bazuar,**

**Pretendimi i dytë i OE ankuesit mëposhtë:**



Sa i përket arsyes së dytë për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit ku AK-ja e ka cekur se oferta jonë e tejkalon buxhetin e AK-së që ka në dispozicion, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së nuk qëndron për faktin se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE oferta e të cilit është me çmim prej 228,979.94 euro për produkt, pra 5 herë më të vogël. Nëse ky produkt krahasohet me produktin tonë me të cilin kemi ofertuar e që është 5 herë më i madh d.m.th.  $228,979.94 \times 5 = 1,144,899.70$  euro, ky produkt do t'i kushton AK-së 150,000.00 euro me shtrenjtë sesa produkti i ofruar nga ana jonë me dozë 5 herë më të madhe se OE i rekomanduar për kontratë. Andaj është për tu habitur se si AK-ja ka ardh në përfundim se oferta e jonë e kalon buxhetin që e ka në dispozicion, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nga llogaria e bërë më lartë i bie që produkti i ofruar nga ai do të i kushtoj AK-së 150,000.00euro më shtrenjtë se sa oferta jonë dhe nuk e tejkalon buxhetin që ka AK-ja në dispozicion. Andaj shihet qartë se ky arsyetim i AK-së për eliminimin tonë është kundërthënës sepse po përdoren standarde të dyfishta ku për ofertën tonë e ka cekur se e tejkalon buxhetin që e ka në dispozicion, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk e tejkalon edhe pse ne e sqaruam më lartë shumë qartë se produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë do të ju kushtojë AK-së 150,000.00 euro më shtrenjtë se oferta jonë, pra ne kemi ofertuar me çmim total prej 992,622.40 euro çmim ky i rritur dhe i arsyetuar nga prodhuesi.

#### **Ekspertja Profesionale sqaron se,**

Për të krahasuar cmimin duhet që fillimisht të kemi kushtet e njejta të krahasimit në vëllim dhe sasi për administrim. Meqenëse kemi të bëjmë me produkt identik në pikëpamjet e koncentrimit të substancës aktive, sugjerojmë që sasia për furnizim të jetë ekuivalente me sasinë e kërkuar për njësi (5000IU për ml) në koordinim me klinikat kërkuese.

**Ekspertja Shqyrtuese** konform Ekspertës Profesionale pretendimin e OE ankuesit e gjenë të bazuar.

#### **Pretendimi i tretë i OE ankuesit mëposhtë:**

Gjithashtu AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kërkesën e parashikuar tek neni 9.1&9.2 i FDT-së në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional ku shkruan **“Kërkesa 2.** Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve të kërkuar. Në rast se nuk ka Autorizim për Marketing në Kosovë, vlen UA 02 2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruar në Republikën e Kosovës”.

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar autorizim marketing për produktin në fjalë sipas udhëzimit administrativ 01/2015, ndërsa nuk janë përmbushur kushtet ligjore për përdorim dhe shfrytëzim të udhëzimit administrativ 02/2014, për shkak se ekziston paralele e produktit e regjistruar në Kosovë (ne e kemi të regjistruar këtë produkt).

Udhëzimi Administrativ 02/2014 për thjeshtësimin e procedurave për importin e produkteve



medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës e parasheh qartë procedurat dhe mënyrën e importimit të produkteve të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Kosovë.

Neni 2 paragrafi 2 i UA 02/2014 e parasheh qartë ku shkruan *“subjekt i këtij udhëzimi administrativ do të jenë vetëm seritë e produkte medicinale që qarkullojnë në tregun e BE dhe të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës”*

Pra kjo dispozitë përcakton qartë dhe flet vetëm për produktet medicinale dhe nuk flet dhe nuk përcakton as dozë e as vëllim të produkteve por i përmend vetëm produktet.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ kuptohet qartë dhe rezulton se ne e kemi të regjistruar produktin dhe është fakt i qartë se ekziston paralele e produktit në Kosovë, prandaj nuk mund të ofertohet nga askush dhe nuk lejohet të ofertohet duke u bazuar në UA 02/2014 në këtë rast, sepse nuk ka hapësirë ligjore përdorimi i të njëjtit udhëzim administrativ.

Në këtë aktivitet të prokurimit OE Agani është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar me produktin e pa regjistruar, duke u munduar të mbështetet tek UA 02/2014, i cili udhëzim lejon importin e produkteve të pa regjistruara në Kosovë, kur nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, andaj OE i rekomanduar për kontratë nuk mund të importoj këtë produkt sipas UA 02/2014, pasi që ne e kemi të regjistruar në Kosovë këtë produkt, pra ekziston paralele, pavarësisht se AK-ja e ka kërkuar dozën më të vogël 1 ml ndërsa ne e kemi ofruar dozën 5 ml. Karakteristika dhe elementi i dozës apo vëllimit nuk është i përcaktuar në udhëzimin administrativ 02/2014 por është i përcaktuar vetëm produkti.

Faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importoj këtë produkt në Kosovë duke u mbështetur tek UA 02/14 e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij me nr.628/20, sikurse është rast edhe tani, e ku e ka vërtetuar pretendimin tonë për Lot 2 dhe e ka cekur se në bazë të nenit 2.5 të UA 02/2014 citojmë *“Baza për vendimmarije në përputhje me këtë udhëzim administrativ do të jetë lista e produkteve të regjistruara në AKPPM në bazë të nivelit të 5 të kodit ATC dhe formës farmaceutike”*, pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk mund ta importojë produktin e kërkuar andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Ne ju referuam ekspertizës në lidhje me ankesën tonë të mëhershme ku rast ka qenë i njëjtë, prandaj OE Agani në këtë rast është i papërgjegjshëm dhe duhet eliminuar nga konkurrenca.

Andaj OE i rekomanduar për kontratë për Lot 3 është i papërgjegjshëm pasi që nuk mund të importoj këtë produkt ku ekziston paralele e këtij produkti në Kosovë.

**Ekspertja Shqyrtuese dhe Profesionale lidhur me pretendimin e lartpërmendur të OE ankuesit për “Autorizimin për Marketing në Kosovë “të lëshuar nga AKPPM, rekomandojnë AK-në që të kërkojnë sqarime nga AKPPM lidhur me hapsirën ligjore për ofertim të produktit bazuar në udhëzimin UA 01/2015 dhe UA 02/2014.**



## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese dhe Ekspertja Teknike/Profesionale i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe se lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues      - SHSKUK
- Panelit Shqyrtues              - OSHP.
- OE ankues                        - OE "LiriMed".